



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0849

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga UD Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi - Kryetare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Shtepia G ShPK” kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “023 Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat e Komunes se Pejes LOT 1- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Baran i ulet,Baran i Eperm,Rrahijet,Callapek,Kosuriq,Penda e Vranocit dhe Broliqit LOT 2- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Loxhe Vragoc,Doberdol dhe Graboc LOT 3- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Pavlan,Gllavicqice,Ramun,Leshan dhe Kliqine LOT 4- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Trestenik,Nabergjane,Llabjan,Dardania III,Ruhot dhe Nakull LOT 5” me nr. të prokurimit 635-24-6773-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, me datë 13.11.2024 mori:

Vendim

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE “Shtepia G ShPK” kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “023 Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat e Komunes se Pejes LOT 1- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Baran i ulet,Baran i Eperm,Rrahijet,Callapek,Kosuriq,Penda e Vranocit dhe Broliqit LOT 2- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Loxhe Vragoc,Doberdol dhe Graboc LOT 3- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Pavlan,Gllavicqice,Ramun,Leshan dhe Kliqine LOT 4- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Trestenik,Nabergjane,Llabjan,Dardania III,Ruhot dhe Nakull LOT 5” me nr. të prokurimit 635-24-6773-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës.

2. Anulohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues ndërsa aktiviteti i prokurimit si në pikën 1 të dispozitivit kthehet në **rivlerësim**

3. Detyrohet Autoriteti Kontraktues për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

4. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrij kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrihet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 03.07.2024 Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “023 Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat e Komunes se Pejes LOT 1- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Baran i ulet,Baran i Eperm,Rrahijet,Callapek,Kosuriq,Penda e Vranocit dhe Broliqit LOT 2- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Loxhe Vragoc,Doberdol dhe Graboc LOT 3- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Pavlan,Gllavicqice,Ramun,Leshan dhe Kliqine LOT 4- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Trestenik,Nabergjane,Llabjan,Dardania III,Ruhot dhe Nakull LOT 5” me nr. të prokurimit 635-24-6773-5-1-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për punë, me vlerë të parashikuar 167,735.90€.

Me datë 29.08.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin përmes të cilit ka rekomanduar për kontratë GOE “Valdrini shpk; Ibrahim Korrumeli; Nisi Ing sh.p.k; Shkëmbim Prokaj B.I”. Me datë 03.09.2024 OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 05.09.2024. Me datë 16.09.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0849.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues:

Pretendimi nr. 1 – “Operatori Ekonomik e kundërshton arsyen eliminuese sipas të cilës nuk është plotësuar aneksi 6 i listes së projekteve” .

Pretendimi nr. 2 – “Operatori Ekonomik e kundërshton arsyen eliminuese lidhur me kërkesën për Lot 5 kërkesa 2 Menaxheri i projektit, -Një ingjnier bachelor ndërtimtari drejtimi hidro i licencuar per menaxhim të resurseve ujore, sasi, cilesi dhe shëndet min 5 vite përvojë pune pas diplomimi”.

Pretendimi nr. 3 – “Anëtarë i GOE të rekomandur për kontratë ka paraqitur një listë të kontratave të cilat nuk janë të natyrës së ngjashme pra kryesisht ka rrugë dhe asfllte në kërkesën 1 për lot 5 ku kërkohet që OE të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të natyrës së ngjashme në vlerë prej 280,000.00 në 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë. Në rast të GOE, udhëheqësi i GOE duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar për punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit. Anëtarët tjerë të GOE skanë fare kontrata të ngjashme”.

Pretendimi nr. 4 – *“GOE i rekomanduar për kontratë është administrativisht i papërgjegjshëm pasi që nuk kanë plotësuar me rregull dokumentet për themelimin e GOE. Të gjithë anëtarët e grupit kanë nënshkruar dhe vulosur marrëveshjen e Themelimit të konzerciumit, por ju mungon deklarata individuale për caktimin e liderit, PO ashtu në një deklaratë e përbashkët në një vend shkruhet se 4 kompanit u morën vesh për themelimin e ndërmarrjes së përbashkët për projektin e lartpërmendur . Në rreshtin tjetër thuhet; te dy kompanit njezëri deklarojnë se janë bashkarisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i jepet kontrata që i bie 2 kompani janë një zëri ndërsa 2 kompani nuk janë njëzëri dhe përgjegjës për përmbajtje të grupit”.*

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 19.09.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 01.10.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me ankesën është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore janë prezantuar si vijon:

Lidhur me pretendimin nr. 1 – *“Gjatë verifikimit të ofertës së OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se OE, ka dorëzuar listën e kontratave dhe duke ju referuar asaj liste vërehet se i njëjti ka referenca të realizuara në vlerë 542.185.55euro. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar”.*

Lidhur me pretendimin nr. 2 – *“Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, ka paraqitur Ingjinjerin e ndërtimit drejtimi Hidroteknik ing. Hatixhe Haxha Hoti, e cila e posedon edhe Certifikatën e Trajnimit - Kurs Trajnimi për Menaxhimin e Resurseve Ujore, Kualitetit, Sigurisë dhe Sasisë të tyre. Nëse e analizojmë këtë certifikatë me atë të cilën e ka prezantuar edhe OE i rekomanduar për kontratë po thuajse janë të njëjta pra të dyjat janë Certifikata, ja bashkëgjës edhe certifikatë të cilën e ka dorëzuar OE i rekomanduar. Pra këtu dallimi është vetëm pse njëra titullohet Certifikatë e Trajnimit kuresë tjetra Certifikatë e Aftësisë. Mendimi i ekspertit shqyrtues është se të dyjat e kanë kuptimin e njëjtë. Andaj rekomandohet që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim duke respektuar nenin 72 të LPP, si dhe të ketë parasysh gjatë rivlerësimit të respektohet neni 7 i LPP pra të bëhet trajtimi i barabart i OE gjatë rivlerësimit”.*

Lidhur me pretendimin nr. 3 – *“eksperti shqyrtues mendon që ky pretendim ankimorë është pjesërisht si i bazuar, pasi që OE i rekomanduar për kontratë në listën e prezantuar shumica e projekteve janë të natyrës së ndërtimit të rrugëve-asfaltit si dhe renovime etj”.*

Lidhur me pretendimin nr. 4 – *“Duke i pasur parasysh pretendimin ankimor të OE ankues, eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerëson se kjo pikë e ankesës është e bazuar pasi që GOE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar deklaratën për themelimin e ndërmarrjes së përbashkët për projektin në fjalë sipas Udhëzuesit të PP Nr. 001-2023. Shihet se*

në këtë konzorcium të OE janë 4 nërsa në një pik tjerter kanë shënuar se te 2 OE janë bashkarisht dhe individualisht përgjegjes për përmbajtjen e grupit”.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3 të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm konstatimeve lidhur me pretendimin e parë, të dytë dhe të tretë ndërsa nuk i ka falur besimin ekspertit shqyrtues sa i përket konstatimeve për pretendimin e katërt.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP .

Lidhur me pretendimin e katërt ankimor Paneli shqyrtues nuk është pajtuar me konstatimin e ekspertit shqyrtues pasi që eksperti shqyrtues nuk e ka analizuar të gjitha dokumentet e ofruara nga tenderuesi i rekomanduar, Paneli Shqyrtues vlerësoj te gjitha dokumentet e ofruara dhe konstatoj se ne dokumentet e ofruara gjenden te gjitha deklaratat per themelimin e grupit si dhe deklaratat e veçanta per secilin anëtar te grupit.

Sipas të thënave më sipër, përveq pretendimit të katërt ekspertit shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet tjera të operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht

Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve,siç u sqarua dhe me lartë, të ekspertit shqyrtues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet e OE ankues janë te bazuara dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluarNjofitimn mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Pejës të datës 29.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “023 Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat e Komunes se Pejes LOT 1- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Baran i ulet,Baran i Eperm,Rrahijet,Callapek,Kosuriq,Penda e Vranocit dhe Broliqit LOT 2- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Loxhe Vragoc,Doberdol dhe Graboc LOT 3- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Pavlan,Gllavicqice,Ramun,Leshan dhe Kliqine LOT 4- Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne fshatrat; Trestenik,Nabergjane,Llabjan,Dardania III,Ruhot dhe Nakull LOT 5” me nr. të prokurimit 635-24-6773-5-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - SHTEPIA G SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: